

Sesioni i pranverës i Grupit të Punës të EUROSAT-t për Auditimet e Mjedisit (WGEA) organizuar nga SAI i Maltës më 15 - 16 maj 2024

Në datat 15-16 maj u zhvillua në modulin hibrid, sesioni i pranverës i Grupit të Punës të EUROSAT-t për Auditimet e Mjedisit (WGEA) ku KLSH anëtarëson, organizuar nga SAI i Maltës.

Tema kryesore e këtij takimi ishte “Çështjet e Sigurisë së Energjisë”. Rëndësia e kësaj teme buron nga ndikimi i saj socio-ekonomik dhe mjedisor, si dhe fondet e konsiderueshme të alokuara nga qeveritë për të përmbushur në mënyrë të besueshme dhe të përballueshme nevojat e energjisë, duke minimizuar problematika si ndërprerjet e furnizimit, çmimet, luhatjet dhe rreziqet gjeopolitike për sigurinë energjetike.



Diskutimet u fokusuan në sigurinë energjetike si alternativë e energjisë, por me çmime të përballueshme, elementët e qëndrueshmërisë që lidhen me sigurinë energjetike, kryerjen e auditimeve në lidhje me disponueshmërinë dhe përdorimin e lëndëve të para kritike. Takimi u fokusua gjithashtu në strategjitë “neto zero” që po zhvillohen dhe zbatohen në të gjithë Evropën.

Në fjalën hapëse të takimit, Auditori i Përgjithshëm i NAO-s së Maltës, z. Charles Deguara vuri në dukje se ky institucion njeh rëndësinë e sigurisë së energjisë në të gjitha nivelet e shoqërisë. Ai shtoi se, si një shtet i vogël, edhe pse sfidat e Maltës në sigurimin e nevojave të saj energjetike mund të kenë tipare të ngjashme me vendet e tjera, këto priren të jenë më të theksuara.



Dr Andy Kerr, shefi i strategjisë, Climate-KIC Holding B.V dhe prof. ing. Cyril Spiteri Staines nga Universiteti i Maltës mbajtën fjalën e tyre në këtë takim. Një tjetër fjalim nga znj. Elina Bardram nga Komisioni Evropian, u mbajt ditën e dytë të takimit. Në këtë sesion u përfshinë gjithashtu prezantime nga SAI-t mbi tema që lidhen me sigurinë e energjisë. Këto diskutime u fokusuan në metodologjitë e miratuara, sfidat e hasura si dhe gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit të propozuara nga SAI-t përkatëse gjatë auditimit të këtij sektori.

Këtë vit WGEA feston 25 vjetorin e krijimit dhe ky sesion pranveror, shënoi edhe këtë moment historik. Në këtë kuadër, titullarët e SAI-ve nga Polonia, Norvegjia dhe Estonia, mbajtën fjalime përkujtimore në rolet e tyre si kryesues në detyrë ose të mëparshëm të këtij Grupi Pune. Nga KLSH, takimi u ndoq online nga audituesit Paolo Xhezo, Olisa Foto, Erand Rroboçi dhe Bush Bushaj.